

Panairet:

Ne kuader te politikave nxitese e promovuese qe shpalosen nga MBUMK edhe ne rajonin tone behet i mundur organizimi i panairove te cilat menaxhohen teresishte nga drejtoria Rajonale e Bujqesise Diber.

Drejtoria e Rajonale e Bujqesise (DRB)ben te mundur organizimin e fermereve, plotesimin e pavioneve me stenda e çadra duke ofrua nje komoditet per fermeret qe marrin pjese me me produkte te ndryshme.

Ne qytetin e Peshkopise qe nga viti 2006 e ne vazhdim jan mbajtur panairove si:

Panairi i Qershise



Organizohet çdo vit ne periudhen **Maj –Qershor**, qe eshte koha e vjeljes se qershive.

Ky panair eshte zhvilluar çdo vit pasi ka nje rritje te pervitshme te fermereve qe marrin pjese ne kete panair, te cilet tregtojne dhe reklamojne produktin e Qershise dhe ne disa raste gjejne treg per shitje.

Eshte vene re nje rritje e konsiderueshme e sip.te tokes, fale programit te skemes mbeshtetese per fermeret.

Vlen te theksohet se rrethe 60% e produktit shkon ne tregun e kryeqytetit.

Çdo vit gjat panairit te qershise numri i fermereve eshte ne rritje.

2. Panairi i Mjaltit dhe i Bimeve Medicinale



Ky panair organizohet ne periudhen Maj-Qershor.

Gjat viteve te fundit eshte vene re nje rritje e numrit te fermereve bleterrites. Si rezultat i bashkepunimit dhe asistences teknike te dhene nga specialistet e DRB-se, eshte bere e mundur qe te kete nje pjesmarrje te kenaqshme me fermeret ku ato kane prezantuar produktin e mjaltit dhe vlerat curative te mjaltit.

Panairi i bimeve medicinale.



Eshte nje panair teper i rendesishem pasi ato paraqesin vlera per kurimin e semundjeve te shumta. Nje tjetër ane pozitive eshte sepse sjellin te ardhura shtese per familjet qe merren me mbledhjen e tyre. Shumica e kurave popullore behet nga perdorimi i bimeve medicinale.

Festa e te vjelave.

Ky panair mbahet ne periudhen Shtator-Tetor te çdo viti dhe eshte organizimi me i madh si ne pjesmarrje ashtu edhe ne produkte.

Ne kete panair pjesmarresit vizitor njihen me produkte bujqesore e blektorale, produkte te agroindustrise, prodhues fidanesh, produkte artizanale etj.

DRB-ja duke qene ne koherence te plote edhe me politikat kombetare per Arroret i ka kushtuar nje vemendje te veçante ku fermeret jane paraqitur me produkte te tilla si arra, lajthi, geshtenje, produkte keto mjaft te kerkuara ne tregun vendas dhe ate te huaj. Ne te gjitha panairret e organizuara nga ana e DRBU-se, nje vemendje e veçante i eshte kushtuar prezantimit te produkteve nepermjet sistemimit te vendeve per fermeret duke i ndare sipas produkteve dhe sipas komunave.

Marketingu ka qene nje tjetër objektivi i DRBU-se, e cila ka asistuar drejtperdrejte tek çdo fermer duke i ofruar asistencen e nevojshme me qellim qe produkti qe tregtohet te jete cilesor dhe i ambalazhuar sic duhet.

Ne kuader te panairit “Festa e te Vjelave” DRBU-ja ne bashkepunim edhe me aktoret e tjere si Qarku Diber ,organizata qe veprojne e ndihmojne ne zhvillimin e rajonit tone ne fushen e bujqesise kane organizuar edhe vizita ne disa ferma potenciale ,takime seminare, workshope qe kane per qellim pasqyrimin, zhvillimin, dhe fuqizimin e metejshem te bujqesise ne Rajon. Ne keto festa tashme tradicionale marrin pjese dhe ftohen perfaqesues te larte te MBUMK-se, perfaqesues vendor e te zgjedhur ne kuvend, KASH.

Nuk mungojn as gatimet tradicionale te Qarkut tone ku te ftuarit kane mundesi ti shijojne ato.

Keto panaiere pervec te tjerash kane sherbyer edhe ne shtimin e aktiviteteve festive kulturore ne qytetin e Peshkopise pasi ato jan shoqeruar me kenge e valle tipike dibrane.



